



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr.103/1 Prot

Pustec, më 21.01.2026

PROJEKT-VENDIM
Nr.1 Datë 21.01.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.101 DATË 24.12.2025 "MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS,
NUMRIN E PUNONJËSVE DHE NIVELIN E PAGAVE TË ADMINISTRATËS DHE AGJENCISË SË
BASHKISË PUSTEC PËR VITIN 2026**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore" i ndryshuar, nën 54 ç " , ligjin 152/2013 "Për nepunësin civil", I ndryshuar, ligjin 9761 dt.12.07.1995 Kodi I Punës së Republikës së Shqipërisë, I ndryshuar, Vendimin Nr.325 ,datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave,niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi page të zëvendësministrit,funksionarëve të kabineteve,prefektit,nënprefektit,nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucioneve të Administratës Publike", Vendimin nr.326, dt.31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialisteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", Vendimin nr.328 datë 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve,grupimin e njësive të vetqeverisjes vendore,për efekt page,dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar,të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetqeverisjes vendore " , Vendimin nr.240 dt.20.04.2023 Për një ndryshim në vendimin nr.419 date.26.06.2024,të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" dhe Vendimin nr.425 datë 26.06.2024 "Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimore në arsimin si dhe në bazë të VKM Nr.776 datë 19.12.2025 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

TË MIRATOJ

1. Të miratojë strukturën organizative të Bashkisë Pustec për vitin 2026, në bazë të VKM nr.776 dt.19.12.2025
2. Ndryshimi i nivelit të pagave sipas këtij vendimi nuk sjell ndryshim në numrin total të punonjësve, por vetëm rregullim të pagës bazë për pozicionet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Të miratojë nivelin e pagës për pozicionin "Përgjegjës i Gjendjes Civile", si funksion i deleguar nga qeverisja qendrore, në përputhje me kategorinë dhe funksionin e përcaktuar në VKM nr. 325, datë 31.05.2023.
4. Struktura organizative e Bashkisë Pustec, e miratuar më parë për vitin 2026, mbetet e pandryshuar përsa i përket ndarjes organizative dhe funksioneve, me përjashtim të nivelit të pagës bazë për punonjësit që preken nga ky vendim.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë Pustec për vitin 2026.
6. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pustec dhe strukturat përgjegjëse për financën dhe burimet njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËS I BURIMEVE NJERËZORE
Vasil STOJAN



KRYETARI I BASHKISË
PALI KOLEFSKI

